



ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Dhjetor 2025



Administrata Doganore e mbylli vitin 2025 me të ardhura të realizuara në vlerën **240 miliardë lekë**, ose rreth **2,5 miliardë euro**. Krahasuar me një vit më parë, janë arkëtuar rreth **10 miliardë lekë** më shumë, që përfaqëson një rritje prej **+4,3%**.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2025, si pasojë e mbivlerësimit të lekut, janë humbur rreth **9,5 miliardë lekë** të ardhura. Kjo do të thotë se rritja reale, krahasuar me një vit më parë, arrin në rreth 19,5 miliardë lekë, ose **+10%**.

Në raport me planin, të ardhurat janë realizuar në masën **98%**, ndërsa duke marrë në konsideratë efektin e kursit të këmbimit, të ardhurat reale rezultojnë rreth **+5 miliardë lekë**, ose **103,3%** e planit.

Këto rezultate pozitive janë arritur si pasojë e miradministrit, forcimit të kontrollit doganor dhe masave të shtuara për reduktimin e evazionit, të cilat kanë rritur ndjeshëm eficiencën në mbledhjen e të ardhurave.

Rezultate rekord janë shënuar edhe në të ardhurat nga mallrat e akcizës. Veçanërisht, karburantet shënojnë një konsum prej rreth **760 mijë tonësh (+75 mijë ton)** krahasuar me një vit më parë, cigaret arritën në 3.450 ton nga 3.200 ton të planifikuara (**+250 ton** krahasuar me një vit më parë), konsumi i kafesë u rrit me rreth **500 ton** dhe ai i birrës me rreth **1.000 ton** më shumë se një vit më parë.

BRUKSEL, NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT NË FUSHËN E DOGANAVE NË KUADËR TË INICIATIVËS “GREEN LANES”

Në Bruksel u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **z. Genti Gazheli**, dhe Autoritetit të Pavarur për të Ardhurat Publike (IAPR) të Republikës Greke, përfaqësuar nga Guvernatori, **z. Georgios Pitsilis**.

Ceremonia e nënshkrimit u organizua nga Komisionerja për Zgjerim, znj. Marta Kos, dhe mbledhi drejtues të autoriteteve doganore, si dhe Drejtorin e CEFTA-s dhe Drejtorin e Komunitetit të Transportit.



Ky Memorandum është pjesë e Iniciativës “Green Lanes”, e cila synon thjeshtimin dhe përsheptimin e kontrolleve kufitare, reduktimin e kohës së pritjes dhe lehtësimin e flukseve tregtare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve partnere të Ballkanit Perëndimor, përmes rritjes së koordinimit dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet administratave doganore.

DREJTORI I DOGANAVE PRET EKIPIN E BB PËR MISIONIN PËRGATITOR TË PROJEKTIT PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TRANSPORTIT

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, **z. Genti Gazheli**, zhvilloi një takim pune me ekipin e Bankës Botërore në kuadër të misionit përgatitor të projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit “Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project (TTFP) 2.0.

Gjatë takimit, palët diskutuan mbi ecurinë e bashkëpunimit të deritanishëm dhe hapat e ardhshëm për përgatitjen e fazës së dytë të projektit, i cili synon përmirësimin e menaxhimit kufitar, lehtësimin e tregtisë dhe modernizimin e shërbimeve doganore. U vlerësua progresi i bërë deri tani, si dhe u shkëmbyen qëndrime mbi investimet prioritare që pritet të realizohen në kuadër të TTFP 2.0 dhe programeve të lidhura me të.



PREZANTOHET PËR HERË TË PARË MANUALI DOGANOR PËR PASAGJERËT

Ministri i Financave, **z. Petrit Malaj** dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, **z. Genti Gazheli**, zhvilluan një inspektim në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” me fokus prezantimin e Manualit Doganor për Pasagjerët, një botim i ri dhe thelbësor i Administratës Doganore Shqiptare.

Ky manual, i publikuar për herë të parë, përmbledh në një dokument të vetëm rregullat kryesore për hyrjen dhe daljen e pasagjerëve nga territori shqiptar, duke ofruar udhëzime të qarta mbi mallrat e lejuara dhe të ndaluara, deklarin e valutës, barnat, kafshët shtëpiake, mbrojtjen e pasurive kulturore dhe procedurat për mjetet e transportit.

Manuali Doganor për Pasagjerët është tashmë i publikuar online dhe i disponueshëm për të gjithë udhëtarët në: https://dogana.gov.al/manuali_pasagjeret.pdf Ky botim i ri përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të shërbimeve doganore dhe garantimit të një përvoje më efikase për qytetarët, në përputhje me standardet evropiane.



TAKIMI I 38-TË I KOMITETEVE TË PËRBASHKËTA TË BE PËR DHE THJESHTIMIN E FORMALITETEVE NË TREGTINË E MALLRAVE

Në Bern të Zvicrës, u zhvillua takimi i 38-të i Komiteteve të Përbashkëta të Bashkimit Evropian për Transit të Përbashkët dhe për Thjeshtimin e Formaliteteve në Tregtinë e Mallrave. Në këtë sesion morën pjesë edhe përfaqësues të Administratës Doganore Shqiptare, në cilësinë e vendit vëzhgues, i cili pritet të marrë statusin e palës kontraktuese dhe vendit kandidat për aderim në Konventën e Transittit të Përbashkët, falë progresit të konstatuar në zbatimin e sistemit NCTS.

Administrata Doganore Shqiptare vijon me intensitet dhe standarde të larta teknike procesin e implementimit të sistemit të transittit të përbashkët (NCTS), fillimisht në nivel kombëtar dhe në fazën pasuese në nivel ndërkombëtar.

